

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.03 Qershor 2024 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

JAROSLAW DEJNEKA , i datelindjes 06/10/1981, e lindur ne BIALA PODLASKA, POLONI dhe banues ne Durres,rruga e plazhit/13, shtetas Polak, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me numer pasaporte EW4668268

MALGORZATA AGNIESZKA RZEMINSKA , e datelindjes 29/08/1979, e lindur ne Zamosc, POLONI dhe banues ne Durres,rruga e plazhit/13, shtetase Polake, madhore me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me numer pasaporte EU3359505,

te cilet me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "**ALBIKE**" shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**ALBIKE**" shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria "**ALBIKE**" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"). Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria "**ALBIKE**" shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagjja nr.13, rruga e Plazhit, pasuria me nr.4/37/ND+1-27, Zone kadastrale 8518,Apartamenti nr.27, Durres.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- **Dhënia me qira e pajisjeve sportive.**
- **Dhënia me qira e makinave.**
- **Ndërmjetësim,shitje mallrash.**
- **Shërbime informatike.**
- **Shitje-blerje, import,eksport e produkteve të ndryshme.**

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë.

Kapitali i shoqërisë është 100,000 leke i përbërë nga 2 kuota dhe zotërohet nga ortakët e shoqërisë si më poshtë :

1. Ortaku Themelues: **JAROSLAW DEJNEKA** zotëruar i 1 (një) kuota me vlerë të përgjithshme 50,000 Leke , i cili përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë,
2. Ortaku Themelues: **MALGORZATA AGNIESZKA RZEMINSKA** zotëruar i 1 (një) kuota me vlerë të përgjithshme 50,000 Leke , e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Vlera totale e Kapitalit të Regjistruar **100,000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit të Paguar **100,000 Leke**, do të paguhet në avance nga ortakët. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundërt të tretteve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë;

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve themelues është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve themelues është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Ortakëve themelues brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9
Administrimi

MALGORZATA AGNIESZKA RZEMINSKA , e datelindjes 29/08/1979, e lindur në Zamosc, POLONI dhe banues në Durres, rruga e plazhit/13, shtetase Polake, madhore me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me numer pasaporte EU3359505,

Emerimi i administratorit është me një afat pesë vjeçar me të drejtë riemerimi, i cili ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të shoqërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.



Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkakut, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "ALBIKE" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKET E SHOQERISE

JAROSLAW DEJNEKA

MALGORZATA AGNIESZKA RZEMINSKA